



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më  
10.06.2019, e cila filloi në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Visare Gashi (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Naime Osmani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Migjen Shala (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA) dhe Rifat Deri (AKR-AA).

**Munguan:** Adrian Berisha (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Blerand Stavileci (PDK), Uran Ismaili (PDK), Arbenita Murseli (AKR-AA) dhe Baton Dushi (Nisma).

**Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.**

**Kryesuesi hapi mbledhjen duke cekur se për këtë mbledhje të jashtëzakonshme është propozuar ky**

### Rend i ditës:

**1. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të ish Sekretares së Shteteve të Bashkuara të Amerikës znj. Medlin Olbrajt**

**Kryesuesi hapi diskutimin**

**Halim Halimi** tha se GP i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka analizuar këtë propozimvendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit për Sekretaren Amerikane të Shtetit Medlin Ollbrajt dhe e mirëpresim këtë propozimvendim për miratim.

**Vala Peshku** tha se secili nga ne kemi me shprehë me votë këtë vendim, por kam një vërejtje në drejtëshkrimin e emrit të znj. Olbrajt, andaj çka nuk është emër shqip ne e tjetërsojmë e shkruajmë si lexohet dhe nuk besoj se kështu ka me qenë emri i bustit.

**Leonora Shabani- Bajraktari** tha se edhe ne si LVV jemi për miratimin e këtij propozimvendimi, kështu që shpresojmë bile të është e të mos përsëritet Bill Klintoni siç e kemi në Dardani.

**Migjen Shala** tha se edhe ne si GP i PDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për miratim.

**Fadil Gashi** tha se në emër të GP të AAK-së e përkrahim këtë propozimvendim për miratim

**Vesel Makolli**, në emër të GP të AKR-së tha se edhe ne e përkrahim këtë propozimvendim për miratim, por kam një vërejtje rreth sjelljes së materialit për të cilin tha se është e pa kuptimtë me i marrë këto vendime në këtë mënyrë. Kështu që për të ardhmen kërkoi që çdo vendim të silllet me kohë.

**Vjosa Hamiti- Krasniqi** kërkoi të dijë se a do të jetë bust apo portret.

**Kryesuesi** tha se do të jetë bust e jo portret.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri, me 38 vota për, u miratua vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e bustit të ish Sekretares së Shteteve të Bashkuara të Amerikës znj. Medlin Olbrajt

Mbledhja përfundoi në orën 10:20

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Agim Kuleta**



Faqe 2 nga 2